

VENDIM
Nr.821, datë 29.7.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I RRUGËS
KOMBËTARE NË SAUK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës kombëtare në Sauk.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 765 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) m², tokë/arë, me vlerë 274 867 (dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, dhe për sipërfaqen 280 (dyqind e tetëdhjetë) m², tokë/truall, me vlerë 702 960 (shtatëqind e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 977 827 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 410 000 (katërqind e dhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 977 827 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) lekë, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 30.7.2009 dhe të përfundojë më 30.10.2009.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS NACIONALE "SAUK"
Fshatrat: SAUK, MJULL BATHORE, FARKË E VOGEL

Nr.	Pronari	Z.K	Nr. Pas.	Arë			Truall			Vlera totale lekë	Shënime
				Sip · m ²	Çmim i m ²	Vlera lekë	Sip. m ²	Çmim i m ²	Vlera lekë		
1	Fatos Selman Brahja	326 6	27/3	134	395	52930				52930	Konfirmuar nga ZRPP
2	Halit Nuredin Brahja	326 6	27/4	37	395	14615				14615	Konfirmuar nga ZRPP
3	Genc Etem Brahja	326 6	27/2	30	395	11850				11850	Konfirmuar nga ZRPP
4	Xenita Hasan Farka	270 4	198/7				12	2517	30204	30204	Konfirmuar nga ZRPP
5	Xhelal Mustafa Metani	270 4	193/9/ 3				20	2517	50340	50340	Konfirmuar nga ZRPP
6	Tire Mustafa Bathorja	270 4	193/10				22	2517	55374	55374	Konfirmuar nga ZRPP
7	Dashamir + Izet Shyqyri Osma	270 4	206/16	23	344	7912				7912	Konfirmuar nga ZRPP
8	Trahshëgimtarët Gjuzi	270 4	206/20	13	344	4472				4472	Konfirmuar nga ZRPP
9	Lumturi Gjuzi	270 4	206/19	74	344	25456				25456	Konfirmuar nga ZRPP
10	Bashkëpronarët Allaraj + Hoxha	270 4	230/13	262	344	90128				90128	Konfirmuar nga ZRPP
11	Nadire Rrushi	270	217/18				18	2517	45306	45306	Konfirmuar nga

		4									ZRPP
12	Sali Lato	270 4	228/2	140	344	48160				48160	Konfirmuar nga ZRPP
13	Drini Baboçi	270 4	30/2				115	2517	28945 5	289455	Konfirmuar nga ZRPP
14	Beqir Husha	270 4	193/8/ 1				18	2517	45306	45306	Konfirmuar nga ZRPP
15	Gëzim Deda	270 4	193/72				15	2517	37755	37755	Konfirmuar nga ZRPP
16	Dashurim + Izet Shyqyri Osma	160 5	211/77				60	2487	14922 0	149220	Konfirmuar nga ZRPP
17	Agim Sali Muharremi	160 5	211/23	52	372	19344				19344	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI			765		274867	280		70296 0	977827	

